

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2023

AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
1.	27.01.2023	Kërkesë për rishqyrtimin dhe ndryshimin e vendimit për refuzimin e lëshimit të CSP.	01.02.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, me lëndë “Kërkesë për rishqyrtimin dhe ndryshimin e vendimit për refuzimin e lëshimit të Certifikatës së Sigurimit të Personelit” në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, Ju bëjmë me dije se: Në nenin 27 “Refuzimi, heqja dhe pezullimi i përkohshëm i CSP-së”, të vendimit të sipërcituar, përcaktohet se: <i>“Njoftimi për vendimin e marrë nga DSIK për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP i komunikohet me shkrim titullarit të strukturës kërkuese, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK.</i> <i>Kjo kërkesë i adresohet titullarit të DSIK brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP. Titullari i DSIK shqyrton dhe vendos për kërkesën e paraqitur brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të saj.</i> <i>Në rastet e mospajtimit me përgjigjen e titullarit të DSIK brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, titullari i strukturës kërkuese ka të drejtë ta ankimojë atë me shkrim tek Kryeministri.”</i>	E plotë	Nuk ka

				DSIK ndjek procedurat për lëshimin, ripajisjen, refuzimin, heqjen dhe pezullimin e “Certifikatës së sigurimit të personelit”, mbështetur në Vendimin nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. DSIK ka të drejtë të marrë vendim për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP në rastet kur, nëpërmjet autoriteteve verifikuese ose/dhe strukturave shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit është përfutur informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP nga një individ i caktuar përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi. Njoftimi për vendimin e marrë nga DSIK për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP i komunikohet me shkrim titullarit të strukturës kërkuese, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK. Kjo kërkesë i adresohet titullarit të DSIK brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP. Titullari i DSIK shqyrton dhe vendos për kërkesën e paraqitur brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të saj. Në rastet e mospajtimit me përgjigjen e titullarit të DSIK brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, titullari i strukturës kërkuese ka të drejtë ta ankimojë atë me shkrim tek Kryeministri. Në DSIK nuk është paraqitur asnjë kërkesë me shkrim nga titullari i strukturës kërkuese, për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK, për S.C. Në mënyrë që DSIK të rishqyrtojë		
--	--	--	--	---	--	--

				vendimin e marrë duhet që kërkesa për rishqyrtim të bëhet nga titullari i strukturës kërkuese. Referuar sa më sipër, DSIK ka përmbyllur procedurën e kontrollit të figurës për S.C me marrjen e vendimit për refuzimin e Certifikatës së Sigurimit të Personelit. Në mbështetje të nenit 29 të vendimit të sipërpërmendur, aplikanti të cilit i është refuzuar CSP ka të drejtë të riaplikojë përsëri me kusht që të ketë kaluar një vit kalendarik nga data e shkresës njoftuese për heqjen ose refuzimin e CSP-së. <i>Aplikanti në çdo rast ka të drejtë të ankimojë vendimin në rrugë gjyqësore.</i>		
2.	03.02.2023	Kërkesë për klasifikimin e informacionit	06.02.2023	Në përgjigje të email-it tuaj me lëndë “Kërkesë për klasifikimin e informacionit”, ju bëjmë me dije se: Informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” prodhojnë vetëm institucionet shtetërore të cilat përmbushin kriteret e përcaktuara ligjore sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar. Klasifikimi “sekret shtetëror” i informacioneve që prodhojnë institucionet shtetërore bazohet në listën e dokumentave të klasifikuara “sekret shtetëror” që është miratuar me urdhër të titullarit të institucionit. Hartimi dhe miratimi i kësaj liste kryhet duke zbatuar me përpikmëri ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 263, datë 12.05.2021 “Për miratimin e rregullores për klasifikimin e informacionit “sekret shtetëror””.	E plotë	Nuk ka
3.	21.02.2023	Procedura për pajisje me Certificate Sigurie	24.02.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj, në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, Ju informoj se:	E plotë	Nuk ka

				Certifikata e Sigurimit të Personelit (CSP), është dokumenti zyrtar i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ose i një autoriteti kompetent të sigurisë së një vendi tjetër i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar. Në zbatim të nenit 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, mënyrat e aplikimit për të pajisur një individ me CSP janë, si më poshtë: a. Me kërkesë të titullarëve të ministrive dhe institucioneve shtetërore ose personave të autorizuar për punonjësit dhe stafet e tyre, të kontraktuarit ose kategoritë e individëve të parashikuar për të marrë pjese në një prokurim të klasifikuar; b. me kërkesë të Autoritetit të Sigurimit Kombëtar të një vendi tjetër, anëtar i NATO-s, BE-së ose vend me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje të përbashkët për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar; c. me kërkesë të autoritetit kompetent të sigurisë së NATO-s, të një strukture të saj apo të BE-së; ç. me kërkesë të drejtpërdrejtë të përfaqësuesit ligjor të një operatori ekonomik vendas, në kuadrin e procedurave për pajisje me CSI e CSP, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Referuar sa sipër, në mbështetje të germës a, të nenit 8, kërkesa për pajisje me CSP, në rastin tuaj, për përkthyesit e licensuar duhet të paraqitet nga titullari i ministrisë. Kërkesa për pajisje me CSP në asnjë rast nuk paraqitet individualisht pranë DSIK.		
--	--	--	--	--	--	--

				Gjithashtu, ju sqarojmë se, pranë çdo ministrie apo institucioni i cili prodhon informacion të klasifikuar është edhe “Oficeri i sigurisë”, i cili është punonjësi përgjegjës ose struktura e ngarkuar nga titullari i ministrisë apo i institucionit shtetëror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave për sigurimin e personelit dhe disiplinat e tjera të informacionit të klasifikuar.		
4.	25.02.2023	Kërkesë për informacion	16.03.2023	Në lidhje me kërkesën tuaj, ju informoj si në vijim: 1. Në lidhje me pyetjen e parë, nëpërmjet të cilës kërkoni vendime të Gjykatave Administrative në të cilat AKSIK (Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar) është thirrur në cilësinë e palës së tretë apo si i paditur për shkak të refuzimit të dhënies së informacionit ndaj paditësit me arsyetimin se informacioni i kërkuar është i klasifikuar "Sekret shtetëror", ju informojmë se nuk ka patur raste të tilla. 2. Në lidhje me pyetjen e dytë, se sa është numri i kërkesave të refuzuara nga AKSIK (Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar) me arsyetimin se, informacioni i kërkuar është i klasifikuar "Sekret shtetëror", ju informoj si më poshtë: • Për vitin 2020 është 0 nga 32 në total • Për vitin 2021 është 3 nga 17 në total; • Për vitin 2022 është 2 nga 22 kërkesa në total; • Për muajin janar 2023, numri është 0.	E plotë	Nuk ka
5.	02.03.2023	Kërkesë për informacion	13.03.2023	Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) kryen detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, dhe ligjin Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.	E plotë	Nuk ka

				Me verifikim të sigurisë kuptohet tërësia e masave dhe e procedurave të aplikuara ndaj një individi, mbi bazën e të cilave do të vlerësohet lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm ose heqja e “Certifikatës së Sigurimit të Personelit”. Verifikimi i sigurisë dhe mbledhja e informacioneve, kryhet për ata individë të cilët për shkak të funksionit të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar. Gjithashtu, AKSIK kryen verifikimin e subjekteve të rivlerësimit, gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatim të detyrimeve të ligjit Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. AKSIK nuk kryen verifikimin e pastërtisë së figurës ndaj jush dhe nuk mbledh apo verifikon informacion në ngarkimin tuaj, pasi nuk jeni subjekt i ligjeve të sipërcituara.		
6.	13.03.2023	Kërkesë për informacion	16.03.2023	Me hyrjen në fuqi të Ligjit 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar", duke filluar nga data 09.03.2023 emërtimi i institucionit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka ndryshuar dhe do të jetë Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK). Në lidhje me automjetin në pronësi të AKSIK të dhënat janë si më poshtë: Autoveturë: Marka Dacia Tipi Sandero Ngjyre: E kuqe Taga: AA 134 NZ	E plotë	Nuk ka
7.	04.04.2023	Kërkesë për rishqyrtimin e refuzimit të CSP	19.04.2023	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit	E plotë	Nuk ka

				të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit” dhe në përgjigje tuajës, ju sqarojmë se: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ndjek procedurat për lëshimin, ripajisjen, refuzimin, heqjen dhe pezullimin e “Certifikatës së sigurimit të personelit”, mbështetur në Vendimin nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. AKSIK ka të drejtë të marrë vendim për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP në rastet kur, nëpërmjet autoriteteve verifikuese ose/dhe strukturave shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit është përfutur informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP nga një individ i caktuar përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi. Në zbatim të nenit 27, të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, njoftimi për vendimin e marrë nga AKSIK për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP i komunikohet me shkrim titullarit të strukturës kërkuese, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga AKSIK. Kjo kërkesë i adresohet titullarit të AKSIK brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP. Titullari i AKSIK shqyrton dhe vendos për kërkesën e paraqitur brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të saj. Në rastet e mospajtimit me përgjigjen e titullarit të AKISK brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit,		
--	--	--	--	---	--	--

				titullari i strukturës kërkuese ka të drejtë ta ankimojë atë me shkrim tek Kryeministri. Në rastin konkret, në AKSIK nuk është paraqitur asnjë kërkesë me shkrim nga titullari i strukturës kërkuese, për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga AKSIK. Aplikanti në çdo rast ka të drejtë të ankimojë vendimin në rrugë gjyqësore.		
8.	19.04.2023	Kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion dokumentat e përshkruara në kërkesë	25.04.2023	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në përgjigje të kërkesës tuaj nëpërmjet të cilës kërkonti vënien në dispozicion të shkresës nr. 3251 Prot., datë 10.11.2022, bashkëlidhur gjeni kopje të njësuar me origjinalin të shkresës së sipërcituar.	E plotë	Nuk ka
9.	03.05.2023	Kërkesë për informacion	17.05.2023	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe në përgjigje tuajës, ju sqarojmë se: 1. Në lidhje me pyetjen e parë, ju lutem të saktësoni se çfarë informacioni kërkonti, duke na vënë në dispozicion emërtimin e dokumentit që kërkonti. Institucionet shtetërore deklasifikojnë informacione të klasifikuara në mbështetje të kriterëve ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar. Është kompetencë e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH) të përbërë nga 7 anëtarë, vendimarrja nëse informacioni do të deklasifikohet apo jo dhe arsyeja ligjore për deklasifikimin e tij. Rastet konkrete të dokumentave të deklasifikuara, sipas nenit 16 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, publikohen nga çdo institucion shtetëror, i cili	E plotë	Nuk ka

				ka detyrimin të publikojë bibliografinë e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të deklasifikuar plotësisht apo pjesërisht, brenda tridhjetë ditëve kalendarike nga marrja e vendimit të KDZH-së. Publikimi bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit. Institucionet që kanë kryer deklasifikime të informacionit të klasifikuar janë si më poshtë: - Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar; - Kyreministria; - Kuvendi i Shqipërisë; - Ministria e Brendshme; - Ministria e Mbrojtjes; - Ministria e Drejtësisë; - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; - Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave; - Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare; - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit; - Prokuroria e Përgjithshme; - Shërbimi Informativ i Shtetit. 2. Në lidhje me pyetjen e dytë, ju sqarojmë se, në zbatim të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, institucionet e administratës publike mbrojnë informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së sipas standardeve që sigurojnë shkallë mbrojtjeje të njëjtë me atë që kërkohet nga NATO dhe BE. 3. Në lidhje me pyetjen e tretë, ju informojmë se, të gjitha shkeljet e sigurisë për rastet e vjedhjes, marrjes, dhënies, humbjes, rrjedhjes, shkatërrimit të paautorizuar të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” duhet të		
--	--	--	--	--	--	--

				raportohen menjëherë te struktura ose oficeri i sigurisë i institucionit të administratës publike dhe nëpërmjet tij tek titullari i këtij institucioni dhe në AKSIK. Në këto raste titullari i institucionit me urdhër të veçantë krijon një komision për të shqyrtuar çështjen. Procedura e konstatimit të shkeljeve të sigurisë, kundërvajtjet administrative dhe sanksionet përcaktohen në nenet 74-76 të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.		
10.	25.05.2023	Kërkesë për informacion	01.06.2023	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në përgjigje tuajës, nëpërmjet të cilës kërkonti kopje të njehësuar me origjinalin të shkresës tuaj, ju sqarojmë se: Nga këqyrja e regjistrit të protokollit të vitit 2017, të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), rezulton se nuk është depozituar asnjë shkresë në emrin tuaj. Rrjedhimisht, AKSIK nuk mund t’ju përcjellë informacion të cilin nuk e disponon.	E plotë	Nuk ka
11.	20.06.2023	Lidhur me pajisjen time me CSP	22.06.2023	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit” dhe në përgjigje tuajës, ju sqarojmë se: Aplikimi juaj është në proces dhe data e aplikimit tuaj është 05.04.2023. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ndjek procedurat për lëshimin, refuzimin, heqjen dhe pezullimin e Certifikatës së Sigurisë të Personelit, mbështetur në Vendimin nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”.	E plotë	Nuk ka

				Referuar nenit 18 “Afatet e kryerjes së verifikimeve të sigurisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 përcaktohet se: <i>Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit dhe lëshimit të CSP-së nga DSIK-së është deri në 120 ditë kalendarike. Brenda kësaj periudhe përfshihen edhe afatet e verifikimit të sigurisë nga ana e autoriteteve verifikuese.</i> <i>Ky afat mund të jetë më i gjatë kur verifikimet kushtëzohen nga kryerja e procedurave në bashkëpunim me autoritetet e sigurimit kombëtar të vendeve të tjera ose kur drejtori i DSIK udhëzon kryerjen e verifikimeve shtesë.</i> Pas përfundimit të procesit të verifikimit, AKSIK do të njoftojë Oficerin e Sigurisë pranë Delegacionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë, në NATO.		
12.	12.06.2023	Kërkesë për deklasifikim informacioni	26.06.2023	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, dhe në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju bëjmë me dije se: Referuar nenit 4 të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurimin e personelit” janë përcaktuar kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar. Sipas nenit 4, kanë të drejtë të njihen, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm individët që: a. sigurojnë të drejtën e njohjes nga titullari i ministrisë/institucionit, ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit për shkak të detyrës që kryejnë; b. kanë zotësi të plotë për të vepruar; c. janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësiive individuale për shkeljet e sigurisë;	E plotë	Nuk ka

				ç. janë të pajisur me Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP), me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar”. Referuar legjislationit në fuqi për informacionin e klasifikuar si dhe praktikës së konsoliduar ndër vite nga DSIK, në cilësinë e autoritetit të sigurimit kombëtar, me parimin “nevojë për njohje” kuptohet nevoja për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar në kuadrin e një funksioni të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale. E drejta “nevojë për njohje” sigurohet nga titullari, të cilit me ligj i është deleguar e drejta e klasifikimit origjinal. Pra, për t’u njohur me një informacion të klasifikuar duhet: 1. Të plotësosh kushtet të pajisesh me CSP; 2. Miratimi i titullarit të institucionit që e ka prodhuar informacionin; 3. Zbatimi i parimit “nevojë për njohje”.		
13.	10.07.2023	Kopje e njehësuar me origjinalin e deklaratës së figurës nr. 475 prot., datë 26.01.2017	11.07.2023 18.07.2023	1. Në lidhje me kërkesën Tuaj nr. 2511 Prot., datë 10.07.2023, me lëndë “Kopje e njehësuar me origjinalin e deklaratës së figurës nr. 475 prot., datë 26.01.2017”, Ju informoj se, Kërkesa për informacion në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë <u>identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij.</u> Në zbatim të pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për arsye se kërkesa për informim nuk përmban elementet e mësipërme, Ju refuzohet dhënia e tij në formën e kërkuar. Me qëllim kthimin e përgjigjes, ju lutem, përcillni ID dhe nënshkrimin në kërkesën tuaj.	Refuzuar E plotë	Nuk ka

				2.Pas dorëzimit të ID, kërkesa u trajtua dhe mori përgjigje.		
14.	19.09.2023	Kërkesë për informacion	25.09.2023	1.Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara në e-mailin Tuaj të datës 18.09.2023 adresuar Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), si dhe referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe akteve nënligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar, ju sqarojmë se: 2.Pajisja me CSP e Znj. E.Gj është kryer në përputhje me procedurat e parashikuara në Vendimin Nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka adresuar kërkesat për verifikimin e sigorisë tek autoritetet verifikuese dhe institucionet shtetërore. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (Ish-SHÇBA), në cilësinë e autoritetit verifikues ka kryer verifikimet përkatëse dhe ka thyer përgjigje me shkresë të klasifikuar. Nga verifikimi i sigorisë i kryer nga autoritet verifikuese dhe institucionet shtetërore nuk është referuar asnjë rekord apo dyshim për përfshirje të mundshme në veprimtari antiligjore që cënon sigurinë kombëtare për znj. E.Gj. 3.Znj. E.Gj, lindur më 29.04.1998, është e pajisur me Certifikatën e Sigurisë së Personelit (CSP)¹ në nivelin “Sekret” më datë 5.07.2019, e vlefshme deri më datë 4.07.2024. Pajisja me CSP është bërë referuar kërkesës së	E plotë	Nuk ka

¹ Bazuar në ligjin Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, “Certifikata e Sigurisë së Personelit (CSP)” është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigorisë së një vendi tjetër, **i cili vërtetohet nga pikëpamja e sigorisë se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara** për njohjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

				bërë nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, bazuar në përcaktimet e legjislacionit në fuqi. 4.AKSIK ka pranuar një kërkesë nga struktura përkatëse e ngarkuar në MB, përmes së cilës kërkohet "...konfirmimi i vlefshmërisë dhe përshtatja e CSP me vendin aktual të punës...". Kjo kërkesë është protokolluar në AKSIK me nr. 5648, datë 30.08.2023. Sqarojmë se kjo kërkesë është duke u shqyrtuar. 5.Aktualisht Znj. E.Gj, zotëron një CSP të vlefshme. Referuar kërkesave të Vendimit Nr. 188, datë 4.3.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit", refuzimi, heqja dhe pezullimi i përkohshëm i CSP, bëhet në rastet kur: "...nëpërmjet autoriteteve verifikuese ose/dhe strukturave shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit është përftuar informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP nga një individ i caktuar, përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar neneve 13 e 14, të kësaj rregulloreje....."² Deri në këto momente, AKSIK nuk disponon asnjë material zyrtar të adresuar nga ndonjë autoritet verifikues apo institucion shtetëror, që do të shërbente si bazë për trajtimin e rastit në përputhje me përcaktimet e paragrafit të parë të nenit 27 të Vendimit Nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit". 6.Në përgjigje të e-mailit Tuaj të datës 20.09.2023 adresuar AKSIK, si dhe referuar kërkesave të ligjit nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar" dhe akteve nënligjore në fuqi		
--	--	--	--	--	--	--

² Shiko neni 27, paragrafi i parë i Vendimit Nr. 188, datë 4.3.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit".

				për informacionin e klasifikuar, ju sqarojmë se Z. E.M nuk është i pajisur me CSP dhe për rrjedhojë nuk ka asnjë kërkesë për konfirmim vlefshmërie dhe modelim në përputhje me të dhënat e reja të vendit të punës. Sqarojmë se një kërkesë e tillë bëhet vetëm në rastet kur individit disponon një CSP të vlefshme, të cilën e ka përfituar në kushtet e ushtrimit të një detyre zyrtare të mëparshme.		
15.	22.09.2023	Kërkesë për vënien në dispozicion të informacionit	27.09.2023	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe akteve nënligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar, në vijim të përgjigjes tonë datë 27.09.2023, ju sqarojmë se: Në lidhje me pyetjen e parë dhe të dytë, referuar listës së dokumenteve të klasifikuara të AKSIK, miratuar me Vendim nr. 154, datë 02.06.2023 “Për listën e informacioneve të klasifikuara "sekret shtetëror" në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar”, baza e të dhënave lidhur me punonjësit e institucioneve shtetërore, të cilët kanë aplikuar, janë pajisur apo u është refuzuar, hequr apo pezulluar CSP, të nxjerra nga baza e të dhënave në AKSIK është e klasifikuar “sekret shtetëror” dhe për këtë arsye nuk mund t’ju vihet në dispozicion. Në mbështetje të nenit 37 të Vendimit Nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, ku përcaktohet se: <i>“Ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë të interesuar janë të detyruar të mbajnë, të administrojnë dhe të përditësojnë regjistrin e modeluar dhe të miratuar nga DSIK-ja dhe bazën elektronike të të</i>	Refuzuar	Nuk ka

				<i>dhënave lidhur me punonjësit dhe stafet e tyre, për të cilët është lëshuar, refuzuar, pezulluar apo hequr CSP-ja”,</i> Ju lutem drejtoheni institucioneve përkatëse për rekordet e këtyre të dhënave.		
16.	10.10.2023	Kërkesë për informacion	23.10.2023	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar dhe në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju bëjmë me dije se: Në kërkesën tuaj, ju referoni shkresën e Autoritetit të Aviacionit Civil të cilët shprehen se, dokumentacioni i kërkuar klasifikohet “sekret shtetëror”. Me qëllim dhënien e një informacioni të plotë e të saktë, ju lutem na vini në dispozicion shkresën që referoni. Në lidhje me kërkesën tuaj mbi mundësinë e pajisjes me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) dhe kriteret që duhen përmbushur, ju sqarojmë si në vijim: Referuar nenit 4 të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurimin e personelit” janë përcaktuar kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar. <u>Sipas nenit 4, kanë të drejtë të njihen</u>, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm individët që: d. sigurojnë të drejtën e njohjes nga titullari i ministrisë/institucionit, ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit për shkak të detyrës që kryejnë; e. kanë zotësi të plotë për të vepruar; f. janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e sigurisë; ç. janë të pajisur me Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP), me përjashtim të rasteve për	E plotë	Nuk ka

				njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar”. Referuar legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar si dhe praktikës së konsoliduar ndër vite nga AKSIK, në cilësinë e autoritetit të sigurimit kombëtar, me parimin “<i>nevojë për njohje</i>” kuptohet nevoja për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar në kuadrin e një funksioni të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale. E drejta “<i>nevojë për njohje</i>” sigurohet nga titullari, të cilit me ligj i është deleguar e drejta e klasifikimit original. Pra, për t’u njohur me një informacion të klasifikuar duhet: 4. Të plotësosh kushtet të pajisesh me CSP; 5. Miratimi i titullarit të institucionit që e ka prodhuar informacionin; 6. Zbatimi i parimit “<i>nevojë për njohje</i>”. Gjithashtu, ju informojmë se, në zbatim të Vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, çdo person fizik dhe çdo punonjës apo strukturë e interesuar brenda ministrisë apo institucionit ka të drejtën për të paraqitur kërkesë për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” me qëllim marrjen në shqyrtim të kërkesës nga Komisioni i Deklasifikimit, Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH).		
17.	21.12.2023	Kërkesë informacion për	28.12.2023	Në përgjigje të shkresës nr. 23 Prot., datë 21.12.2023 në mbështetje të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju bëjmë me dije se:	Pjesërisht	Nuk ka

				1. Në lidhje me kërkesën Tuaj për deklasifikimin e plotë të informacionit, ju sqarojmë: Në rastin kur Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) në një institucion shtetëror shqyrton deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që nuk është prodhuar nga ky institucion, fton të marrë pjesë në mbledhje një përfaqësues nga institucioni origjinator i cili ka prodhuar informacionin. Në zbatim të Vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, në përfundim të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, KDZH vendos: - deklasifikimin e plotë ose deklasifikimin e pjesshëm të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”; - përfundimin nga deklasifikimi të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”; - zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, duke përcaktuar edhe afatin e ri të ruajtjes së klasifikimit. Në rastin Tuaj, AKSIK ka ftuar të marrë pjesë në KDZH, përfaqësuesin e institucionit i cili është origjinator i informacionit të klasifikuar. KDZH është mbledhur në AKSIK dhe ka gjykuar deklasifikimin e pjesshëm të raportit, përkatësisht: - Me vendim nr. 306, datë 10.10.2022 KDZH ka deklasifikuar pjesërisht raportin nr. 12441 Prot., datë 02.11.2017. 2. Në lidhje me kërkesën Tuaj për vënien në dispozicion të dokumentacionit të administruar në		
--	--	--	--	--	--	--

				ngarkim të subjektit Ilir Hoxha pranë AKSIK apo çdo institucioni tjetër, ju sqarojmë se: Raporti i cili hartohet nga Grupi i Punës për Kontrollin e Figurës përmban të dhëna dhe informacione të përfutuara nga Autoritetet Verifikuese, të cilat janë të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar dhe nuk mund t’ju vihen në dispozicion. Referuar nenit 28, të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” një person mund të njihet me një informacion të klasifikuar nëse ai siguron një të drejtë njohjeje nga një drejtues institucioni apo personi, të cilit me ligj i është deleguar një e drejtë e tillë, kur: a. personi ka nevojë për njohje informacioni për përmbushjen e interesave dhe qëllimeve të ligjshme; b. personi është i pajisur me CSP; c. siguron të drejtën e njohjes për shkak të detyrës që kryen nga titullari i ministrisë/institucionit; ç. personi ka nënshkruar një marrëveshje për mosekspozimin e informacionit; d. personi ka garanci sigurie; Referuar sa sipër, në mbështetje të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar, dokumentacioni i kërkuar nga ana juaj është i klasifikuar dhe nuk mund t’ju vihet në dispozicion.		
--	--	--	--	--	--	--